



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO  
**GJYKATA KUSHTETUESE**  
**УСТАВНИ СУД**  
**CONSTITUTIONAL COURT**

Prishtinë, më 1 gusht 2016  
Nr. ref.: RK 973/16

## **AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI**

në

**rastin nr. KI59/16**

Parashtrues

**Agjencia Kosovare e Privatizimit**

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Kolegjit të Ankesave të  
Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështje që  
lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, AC-I-15-0237, të 18 shkurtit  
2016**

### **GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare  
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar  
Robert Carolan, gjyqtar  
Altay Suroy, gjyqtar  
Almiro Rodrigues, gjyqtar  
Snezhana Botusharova, gjyqtare  
Bekim Sejdiu, gjyqtar  
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe  
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

#### **Parashtruesi i kërkesës**

1. Kërkesa është dorëzuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), e përfaqësuar nga zyrtarët e saj, z. Armend Hamzaj dhe z. Agron Kajtazi.

## **Vendimi i kontestuar**

2. Parashtruesi i kërkesës konteston Vendimin e Kolegjit të Ankesave të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme: Kolegji i Ankesave), AC-I-15-0237, të 18 shkurtit 2016.
3. Vendimi i kontestuar i është dorëzuar parashtruesit të kërkesës më 2 mars 2016.
4. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) të vendosë masë të përkohshme që *“ti pezulloj të gjitha seancat gjyqësore [të Dhomës së Posaçme], ku si palë paraqitet AKP-ja apo një Ndërmarrje Shoqërore”*.

## **Objekti i çështjes**

5. Objekt i çështjes është shqyrtimi i kushtetutshmërisë së vendimit të kontestuar, për të cilin pretendohet se *“ka shkelur parimet bazë të së drejtës siç janë parimi Res Judicata dhe Ne bis in Idem” (...)* dhe *“ka bërë edhe shkelje kushtetuese të nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës”*.

## **Baza juridike**

6. Kërkesa bazohet në nenet 21.4, 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta), në nenin 27.1 dhe nenin 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullat 29 dhe 54 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

## **Procedura në Gjykatë**

7. Më 29 mars 2016, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatë.
8. Më 31 mars 2016, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Almiro Rodrigues gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Ivan Cukalović (kryesues), Arta Rama-Hajrizi dhe Gresa Caka-Nimani.
9. Më 5 prill 2016, Gjykata e informoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Dhomës së Posaçme.
10. Më 13 qershor 2016, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

## **Përmbledhja e fakteve**

11. Më 17 janar 2011, një palë e interesuar ushtroi padi në Kolegjin e Specializuar (SCL-11-0003) kundër parashtruesit të kërkesës, me anë të së cilës kërkonte kompensimin e të ardhurave personale në një shumë të caktuar në euro, duke përfshirë edhe kamatën ligjore deri në pagesën përfundimtare.

12. Më 2 qershor 2015, Kolegji i specializuar mbajti seancë, ku parashtruesi i kërkesës përfaqësohej nga përfaqësuesit e autorizuar të AKP-së.
13. Më 27 tetor 2015, Kolegji i specializuar mbajti edhe një seancë tjetër ku përfaqësuesit të njëjtë, të autorizuar të AKP-së, u paraqitën përsëri për të përfaqësuar parashtruesin e kërkesës. Megjithatë, Kolegji i specializuar nuk i lejoi ata ta përfaqësonin të paditurin sepse ata nuk ishin regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, por ishin të regjistruar në Dhomën e Avokatëve të Shqipërisë.
14. Më 28 tetor 2015, Kolegji i specializuar (Vendimi SCL-11-0003) vendosi që *“përfaqësuesit e [Agjencisë Kosovare të Privatizimit-AKP] së paditurës (...) përjashtohen nga rasti meqenëse nuk janë anëtarë të një Ode Avokatie apo Ode të Avokatëve në Kosovë”*.
15. Më 30 tetor 2015, parashtruesi ushtroi ankesë me anë të së cilës kërkonte anulimin e vendimit të lartpërmendur, unifikimin e praktikës gjyqësore për raste të njëjta dhe kompensimin e parashtruesit për çdo paushall gjyqësor që duhej paguar për ankesën e tij. Për më tepër, parashtruesi i kërkesës pohonte se kushti i vetëm ligjor për përfaqësuesin është që ai të jetë anëtar i “një” shoqate apo ode avokatësh.
16. Më 18 shkurt 2016, Kolegji i ankesave (Vendimi AC-I-15-0237) e hodhi poshtë si të papranueshme *“ankesën kundër vendimit të Kolegjit të specializuar të DHPGJS-së, SCL-11-0003, të datës 28 tetor 2015”*, për shkak të *“parimit që çdo paditës dhe i paditur duhet të përfaqësohet nga një anëtar i një ode avokatie apo një ode të avokatëve”*.

### **Pretendimet e parashtruesit të kërkesës**

17. Parashtruesi pretendon se janë shkelur *“parimet e drejtësisë, si parimi Res Judicata dhe Ne bis in idem”* dhe *“neni 31 i Kushtetutës së Kosovës”*.
18. Parashtruesi gjithashtu pretendon se Dhoma e Posaçme *“ka bërë edhe shkelje kushtetuese të nenit 31 të Kushtetutës së Kosovës i cili parasheh: “Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike”*.
19. Parashtruesi i kërkon Gjykatës *“të anuloj aktvendimin e Kolegjit të Specializuar ASCL-11-0003 i datës 28 Tetor 2015 dhe aktvendimin e Kolegjit të Apelit AC-I-15-0237 i datës 18 shkurt 2016, të lëshuara nga Dhoma e Posaçme”*.
20. Në fund, parashtruesi i kërkon Gjykatës të vendosë masë të përkohshme për të shmangur situatën ku *“AKP-së dhe ndërmarrjeve shoqërore të cilat njëkohësisht përfaqësohen nga AKP-ja si administratore e tyre do t’iu shkaktohej dëmi i pariparueshëm”*.

## Pranueshmëria e kërkesës

21. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri, të përcaktuara në Kushtetutë dhe të specifikuara më tej në Ligj dhe në Rregullore të punës.
22. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 21 [Parimet e Përgjithshme] dhe nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:
- Neni 21  
(...)
- 4. Të drejtat dhe liritë themelore të parashikuara në Kushtetutë, vlejnë edhe për personat juridikë, për aq sa janë të zbatueshme.*
- Neni 113
- 1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.  
(...)*
- 7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.*
23. Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës], i cili përcakton se:
- “Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.*
24. Përveç kësaj, Gjykata merr parasysh edhe rregullin 36 [Kriteret e pranueshmërisë] (1) (d) dhe (2) (d) të Rregullores së punës, i cili parasheh se:
- “(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:  
[...]  
(d) kërkesa nuk arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.*
- (2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:  
[...]  
(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij”.*
25. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon “shkelje të nenit 31 të Kushtetutës”, sepse vendimi i kontestuar kishte shkelur të drejtat e tij “që të përfaqësohet nga zyrtarët e saj pranë DHPGJSK”. Parashtruesi i kërkesës, gjithashtu, i referohet shkeljes së parimit *res judicata* dhe *ne bis in idem*.

26. Gjykata më tej vëren se argumenti kryesor i parashtruesit të kërkesës është nëse ligji i aplikueshëm në Kosovë duhet të interpretohet në atë mënyrë që t'i kërkojë parashtruesit të përfaqësohet në procedurat pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme nga një avokat i regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës ose të një avokati të zgjedhur nga ai.
27. Në të vërtetë, parashtruesi i kërkesës ankohe se Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme kishte interpretuar gabimisht ligjin në lidhje me përfaqësim dhe konsideron se Dhoma e Posaçme duhej të kishte interpretuar ndryshe dispozitat përkatëse ligjore.
28. Në këtë drejtim, në pjesën përkatëse të Aktgjykimit të Kolegjit të Ankesave shkruhet:

*“Ligji për Dhomën e Posaçme dhe Shtojca nuk i përgjigjen kësaj pyetjeje. Se neni 24.1 i Shtojcës përmend anëtarët e një "shoqate avokatësh apo një ode të avokatëve" nuk e përcakton në mënyrë të sigurt nëse është menduar për anëtarët e shoqatave tjera të avokatëve apo ode të avokatëve përveç atyre të Kosovës. Para së gjithash një gjë e tillë duhet të pranohet se rregulli i qartë që palët duhet të përfaqësohen nga një anëtar i Odës së Avokatëve të Kosovës ose të Serbisë dhe e drejta e përzgjedhjes së gjyqtarit kryesues për të lejuar anëtarët e një ode përveç në Kosovë apo Serbi është dhënë nga legjislacioni i mëparshëm (shih nenin 24.1 dhe 24.3 i Urdhëresës Administrative të UNMIK-ut 2008/6), janë zëvendësuar nga ligjvënësi në nenin 24.1 të Shtojcës, duke deklaruar se çdo paditës dhe i paditur duhet të përfaqësohet nga një anëtar i shoqatës së avokatëve apo Ode të avokatëve. Për më tepër, nuk mund të injorohet se përcaktimi i një definicioni të paqartë ligjor si “anëtar i shoqatës së Avokatëve apo odës së avokatëve” në Ligjin e Kosovës duhet të arrihet në kuadër të kornizës ligjore të Kosovës. Ligji i Kosovës i cili trajton problemin në fjalë është Ligji Nr. 04/L-193 për Avokatinë (LOAK). Ky ligj rregullon të drejtën për të ushtruar profesionin e avokatit në Kosovë, përfshirë edhe të drejtën e audiencës në gjykatat e Kosovës. Sipas nenit 1.1. të LOAK-së e drejta për të ushtruar avokatinë në Kosovë jipet pas regjistrimit në Regjistrin e Odës së Avokatëve të Kosovës. Edhe pse parakushtet dhe procedurat për t'u regjistruar janë të ndryshme për avokatët vendas dhe avokatët e huaj, këta të fundit kanë mundësinë për t'u regjistruar dhe për t'u lejuar që të ushtrojnë avokatinë në Kosovë. Në bazë të nenit 40.1 të LOAK-së, Avokatët nga shtetet e tjera mund të ushtrojnë profesionin e avokatit në territorin e Republikës së Kosovës nën kushtet e reciprocitetit dhe duhet të ketë një konfirmim të marrëveshjes reciproke nga ana e Ministrisë së Drejtësisë pasi të ketë marrë një opinion nga Oda e Avokatëve. Kjo çështje është e rregulluar në mënyrë eksplicite me nenin 2 të aneksit të Statutit të Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), i cili parasheh se "Shtetasit e huaj kandidatet për ushtrimin e avokatisë në Kosovë, duhet ti nënshtrohen provimit të përshtatshmërisë në organizuar nga OAK, në njërin nga gjuhët zyrtare në Kosovë. Forma, përmbajtja dhe procedurat tjera të provimit të përshtatshmërisë përcaktohen në Rregulloren për Licencimin e Avokatëve të huaj." Përrjashtim nga ky rregull është vetëm për avokatët nga shtetet anëtare të Bashkimit Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Të dy avokatët e huaj nga vendet e tjera dhe nga shtetet anëtare të BE-së dhe SHBA-ve duhet të jenë të regjistruar në regjistrin e posaçëm të Avokatëve*



*të Odës së Avokatëve të Kosovës (OAK), me kusht të ofrimit të një dokumenti që dëshmon se ata janë të regjistruar në shtetet e tyre dhe se ata e ushtrojnë avokatinë (neni 40.5 i LOAK-së). Në bazë të autorizimit të lëshuar nga AKP-ja, avokatët Gentian Gurra dhe Rudi Metaj, e kishin përfaqësuar AKP-në në procedurën pranë Gjykatës së Shkallës së I-rë në lëndën SCL-11-0G03 duke u prezentuar se ata janë avokat të licencuar nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë në Shqipëri. Këta Avokat të cilët janë paraqitur si përfaqësues të AKP-së, nuk kanë ofruar Gjykatës dëshmi se janë të regjistruar në regjistrin e Odës së Avokatëve të Kosovës”.*

29. Gjykata vëren se Kolegji i Ankesave ka shpjeguar kuptimin e nenit 24.1 të Shtojcës së Ligjit për Dhomën e Posaçme; kërkesat e ndryshme midis legjislacionit të mëparshëm dhe atij aktual; kërkesat ligjore që avokatët duhet të plotësojnë për të përfaqësuar paditësit ose të paditurit pranë Dhomës së Posaçme. Pas shqyrtimit të këtyre çështjeve ligjore, ai konkludoi se avokatët që e përfaqësojnë parashtruesin e kërkesës në procedurat gjyqësore para tij nuk janë avokatë të regjistruar në Odën e Avokatëve të Kosovës, siç kërkohet me ligjin që aplikohet në Kosovë.
30. Gjykata konsideron se parashtruesi i kërkesës pretendon shkelje të parimeve juridike, si dhe nenin 31 të Kushtetutës, pa ofruar mbështetje apo shpjegime lidhur me mënyrën se si kanë ndodhur këto shkelje. Parashtruesi i kërkesës bazon pretendimin e tij në interpretimin e gabuar të ligjit të aplikueshëm. Ky argument procedural ka të bëjë me fushën e ligjshmërisë dhe si i tillë nuk bie nën juridiksionin e Gjykatës Kushtetuese, dhe, prandaj, nuk mund të shqyrtohet nga Gjykata.
31. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se nuk është detyrë e saj të merret me gabimet e fakteve apo të ligjit që pretendohet të jenë kryer nga gjykatat e rregullta (ligjshmërisë), përveç dhe për aq sa ato të mund të kenë shkelur të drejtat dhe liritë e mbrojtura me Kushtetutë (kushtetutshmërinë). Ajo mund të mos e vlerësojë ligjin në bazë të të cilit gjykatat e rregullta kanë nxjerrë një vendim në vend të tjetrit, sepse po të ishte ndryshe, Gjykata do të vepronte si “gjykatë e shkallës së katërt” çka do të nënkuptonte shpërfillje të kufizimit të juridiksionit të saj. Në të vërtetë, është detyrë e gjykatave të rregullta të interpretojnë dhe të zbatojnë rregullat përkatëse të së drejtës procedurale dhe të asaj materiale (Shih, *Garcia Ruiz kundër Spanjës*, [DHM], nr. 30544/96, para. 28, Gjykata Evropiane për të Drejtat e Njeriut [GJEDNJ] 1999-I; rasti nr. KI72/14, parashtruese e kërkesës *Besa Qirezi*, Aktgjykim i 4 shkurtit 2015, para. 65).
32. Përveç kësaj, Gjykata konsideron se Aktgjykimi i Kolegjit të Apelit tërësisht iu përgjigj dhe i arsyetoi argumentet në ankesën e parashtruesit. Parashtruesi i kërkesës nuk tregoi dhe dëshmoi para Gjykatës se procedurat në Dhomën e Posaçme ishin të padrejta apo arbitrare apo që të drejtat dhe liritë e tij të mbrojtura me Kushtetutë, janë shkelur me interpretimin që pretendohet të jetë i gabuar të ligjit të aplikueshëm për përfaqësim.
33. Gjykata thekson se interpretimi i ligjit të aplikueshëm për përfaqësim është çështje e ligjshmërisë. Asnjë çështje kushtetuese nuk është vërtetuar dhe dëshmuar nga parashtruesi i kërkesës.

34. Gjkata përsërit se, si rregull i përgjithshëm, interpretimi i ligjit është çështje vetëm për gjykatat e rregullta, të gjeturat dhe konkluzionet e të cilave në këtë drejtim janë të detyrueshme për Gjykatën. Megjithatë, kur një vendim i një gjykate të rregullt është qartazi arbitrar, Gjykata mund dhe duhet ta vë atë në dyshim (Shih *Sisojeva dhe të tjerët kundër Letonisë*, [DHM], Aktgjykimi nr. 60654/00, Aktgjykim i 15 janarit 2007, para. 89).
35. Referimi i parashtruesit të kërkesës në shkeljen e parimeve *res judicata* dhe *ne bis in idem* nuk do të shqyrtohet nga Gjykata, pasi që është një argument i parëndësishëm dhe jo me vend për diskutimin e rastit të parashtruesit të kërkesës.
36. Përveç kësaj, Gjykata vëren se parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit; megjithatë, mospajtimi nuk mund t'i shërbejë atij si e drejtë të ngre kërkesë të argumentueshme për shkelje të neneve 29 [E Drejta e Lirisë dhe Sigurisë], 30 [Të Drejtat e të Akuzuarit] dhe 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (Shih për shembull, Gjykata Kushtetuese rasti nr. KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).
37. Prandaj, Gjykata konstaton se kërkesa e parashtruesit nuk i plotëson kërkesat për papranueshmëri të përcaktuara me Kushtetutë, të parapara me Ligj dhe të specifikuar me Rregullore të punës.
38. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe, në pajtim me rregullin 36 (1) (d) dhe (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, ajo është e papranueshme.

### **Kërkesa për masë të përkohshme**

39. Parashtruesi i kërkesës i ka kërkuar Gjykatës të vendosë masën e përkohshme që të *“pezulloj të gjitha seancat gjyqësore [në Dhomën e Posaçme] ku si palë paraqitet AKP-ja apo një Ndërmarrje Shoqërore”*.
40. Parashtruesi nuk ka ofruar asnjë argument apo arsye lidhur me atë se pse duhet që Gjykata të vendosë masën e përkohshme. Parashtruesi thjesht e ka kërkuar atë në kërkesën e tij.
41. Në mënyrë që Gjykata të vendosë masën e përkohshme, në pajtim me rregullin 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, nevojitet që:

*“(a) pala që kërkon masën e përkohshme ka treguar (...), nëse akoma nuk është vendosur për pranueshmërinë e saj, rastin prima facie për pranueshmërinë e kërkesës;*

*(b) pala që kërkon masë të përkohshme ka dëshmuar se do të pësojë dëme të pariparueshme nëse nuk lejohet masa e përkohshme; dhe*

*[...]*

*Nëse pala që kërkon masë të përkohshme nuk paraqet dëshmitë e nevojshme, Kolegji shqyrtues do të rekomandojë refuzimin e kërkesës”.*

42. Siç u përmend më lart, parashtruesi i kërkesës nuk ka treguar rast *prima facie* për pranueshmërinë e kërkesës. Rrjedhimisht, kërkesa për masë të përkohshme duhet të refuzohet si e pabazuar.

### **PËR KËTO ARSYE**

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenet 21.4, 113.7 dhe 116.2 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit dhe rregullat 36 (1) (d) dhe (2) (d) dhe 55 (4) dhe (5) të Rregullores së punës, më 13 qershor 2016, njëzëri

### **VENDOS**

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T’ UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20. 4 të Ligjit; dhe
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.


**Gjyqtari raportues**



Almiro Rodrigues



**Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese**



Arta Rama-Hajrizi